ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL MALISHEVE**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **625-26-2637-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **SERVISIMI DHE MIRËMBAJTJA E AUTOMJETEVE ZYRTARE TË KOMUNËS SË MALISHEVËS**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**D.P.Z.„Naimi"**
NUI	**600414320**
Adresa	**MALISHEVË**
Vendi	**MALISHEVË**
Kodi postar	**24000**
Numri Telefonit	**+38349717441**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**HAKI HOXHA**
Adresa elektronike	**haki.hoxha12@outlook.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**05.11.2026**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

SERVISIMI DHE MIRËMBAJTJA E AUTOMJETEVE ZYRTARE TË KOMUNËS SË MALISHEVËS

Më datë 24.04.2026, Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë dhe dokumentet e tenderit për aktivitetin e prokurimit "Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve zyrtare të Komunës së Malishevës", me nr. 2026/625-26-2637-2-1-1.

-Më datë 13.05.2026, Operatorët Ekonomik kanë dorëzuar ofertat për këtë aktivitet të prokurimit.

-Më datë 26.05.2026, Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e AK-së, përmes të cilit për kontratë është rekomanduar një operator tjetër ekonomik.

-Pas paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim dhe refuzimit të saj nga Autoriteti Kontraktues, kemi paraqitur ankesë pranë OSHP-së.

-Me Vendimin nr. 0371/2026, të datës 29.06.2026, OSHP-ja ka konstatuar shkelje në vlerësimin e ofertave dhe ka detyruar Autoritetin Kontraktues që lëndën ta kthejë në rivlerësim.

-Gjatë rivlerësimit, më datë 21.07.2026, Autoriteti Kontraktues ka publikuar vendim për anulimin e aktivitetit të prokurimit, duke e konsideruar ofertën tonë si ofertë që tejkalon vlerën e parashikuar të kontratës.

-Kundër këtij vendimi kemi paraqitur kërkesë për rishqyrtim dhe, pas refuzimit nga Autoriteti Kontraktues, ankesë pranë OSHP-së.

-Me Vendimin e OSHP-së nr. 2026/0569, të datës 15.09.2026, Autoriteti Kontraktues është detyruar ta anulojë vendimin për anulimin e procedurës dhe lëndën ta kthejë në rivlerësim.

-Megjithatë, më datë 26.10.2026, Autoriteti Kontraktues ka publikuar përsëri Njoftimin mbi Vendimin e AK-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit, ku si arësye e anulimit të procedurës përmendet një Vendim I ZKA-së e I cili është në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së lidhur me përfundimin e aktivitetit të prokurimit. Në këtë Vendim AK na ka dërguar Letrën Standarde për Tenderuesin e Pasuksesshëm, qka nënkupton se ne kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së.

Për rrjedhojë, vendimi i datës 26.10.2026 paraqet përsëritje të anulimit të procedures në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së, e po ashtu AK ka vepruar në kundërshtim me dy vendimet paraprake të OSHP-së, të cilat vendime e kanë detyruar Autoritetin Kontraktues ta kthejë lëndën në rivlerësim.

Me date: 26.10.2026 Kemi bere kerkese per rishqyrtim te Vendimit te AK, por AK perseri na ka refuzuar kerkesen dhe ka lene ne fuqi Vendimin per Anulim !!!.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ ***Jo*** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Me date: 26.10.2026 Kemi bere kerkese per rishqyrtim te Vendimit te AK, por AK perseri na ka refuzuar kerkesen dhe ka lene ne fuqi Vendimin per Anulim !!!.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 Qëllimi
Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit
Neni 105 Kompetencat e OSHP-së
Rregullore Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik,
Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 43 Ndërprerja e procedurave të prokurimit

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Përshkrim i përgjithshëm

-Më datë 24.04.2026, Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë dhe dokumentet e tenderit për aktivitetin e prokurimit "Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve zyrtare të Komunës së Malishevës", me nr. 2026/625-26-2637-2-1-1.

-Më datë 13.05.2026, Operatorët Ekonomik kanë dorëzuar ofertat për këtë aktivitet të prokurimit.

-Më datë 26.05.2026, Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e AK-së, përmes të cilit për kontratë është rekomanduar një operator tjetër ekonomik.

-Pas paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim dhe refuzimit të saj nga Autoriteti Kontraktues, kemi paraqitur ankesë pranë OSHP-së.

-Me Vendimin nr. 0371/2026, të datës 29.06.2026, OSHP-ja ka konstatuar shkelje në vlerësimin e ofertave dhe ka detyruar Autoritetin Kontraktues që lëndën ta kthejë në rivlerësim.

-Gjatë rivlerësimit, më datë 21.07.2026, Autoriteti Kontraktues ka publikuar vendim për anulimin e aktivitetit të prokurimit, duke e konsideruar ofertën tonë si ofertë që tejkalon vlerën e parashikuar të kontratës.

-Kundër këtij vendimi kemi paraqitur kërkesë për rishqyrtim dhe, pas refuzimit nga Autoriteti Kontraktues, ankesë pranë OSHP-së.

-Me Vendimin e OSHP-së nr. 2026/0569, të datës 15.09.2026, Autoriteti Kontraktues është detyruar ta anulojë vendimin për anulimin e procedurës dhe lëndën ta kthejë në rivlerësim.

-Megjithatë, më datë **26.10.2026**, Autoriteti Kontraktues ka publikuar përsëri Njoftimin mbi Vendimin e AK-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit, ku si arësye e anulimit të procedurës përmendet një Vendim I ZKA-së e I cili është në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së lidhur me përfundimin e aktivitetit të prokurimit. Në këtë Vendim AK na ka dërguar Letrën Standarde për Tenderuesin e Pasuksesshëm, qka nënkupton se ne kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së.

Për rrjedhojë, vendimi i datës 26.10.2026 paraqet përsëritje të anulimit të procedures në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së, e po ashtu AK ka vepruar në kundërshtim me dy vendimet paraprake të OSHP-së, të cilat vendime e kanë detyruar Autoritetin Kontraktues ta kthejë lëndën në rivlerësim.

Me date: 26.10.2026 Kemi bere kerkese per rishqyrtim te Vendimit te AK, por AK perseri na ka refuzuar kerkesen dhe ka lene ne fuqi Vendimin per Anulim !!!.

Pretendimi 1: Moszbatimi i Vendimit të OSHP-së nr. 2026/0569, të datës 15.09.2026

Autoriteti Kontraktues, duke mos vepruar në përputhje me Vendimin e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) nr. 2026/0569, të datës 15.09.2026, me të cilin është urdhëruar kthimi i aktivitetit të prokurimit në rivlerësim, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar, si dhe me dispozitat përkatëse të legjislacionit dytësor për prokurimin publik.

Vendimet e OSHP-së janë detyruese për Autoritetet Kontraktuese dhe duhet të zbatohen në përputhje me përmbajtjen, arsyetimin dhe udhëzimet e përcaktuara në to. Për rrjedhojë, kthimi i aktivitetit të prokurimit në rivlerësim nuk përbën një veprim formal, por një detyrim ligjor që kërkon nga Autoriteti Kontraktues të kryejë një proces të mirëfilltë të rivlerësimit, duke shqyrtuar dhe adresuar çështjet dhe shkeljet e konstatuara në vendimin e OSHP-së.

Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues nuk e ka zbatuar në mënyrë të mirëfilltë vendimin e lartcekur, pasi që AK-së, ka vazhduar me rezultatin e mëparshëm pa i trajtuar gjetjet e OSHP-së, ka përsëritur të njëjtin vlerësim pa arsyetim të mbështetur në prova dhe ka nxjerrë vendim të ri pa i adresuar udhëzimet e përcaktuara në vendimin e OSHP-së.

Një veprim i tillë e cenon efektivitetin e shqyrtimit administrativ dhe të mekanizmit të mbrojtjes juridike të paraparë me Ligjin për Prokurimin Publik. Gjithashtu, bie ndesh me nenin 59 të LPP-së, lidhur me ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, si dhe me dispozitat përkatëse të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të ndryshuar dhe plotësuar, për aq sa ato rregullojnë procesin e rivlerësimit dhe zbatimin e vendimeve të OSHP-së.

Për më tepër, moszbatimi i vendimit të OSHP-së cenon parimet e ligjshmërisë, transparencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, si dhe të drejtën e operatorit ekonomik ankues për një shqyrtim efektiv të pretendimeve të tij. Këto parime kërkojnë që çdo vendim i Autoritetit Kontraktues të mbështetet në dispozitat ligjore, dokumentet e tenderit, provat përkatëse dhe arsyetim të qartë e të verifikueshëm.

Pretendimi 2: Anulimi i kundërligjshëm i aktivitetit të prokurimit, me arsyetimin e mungesës së buxhetit, pa bazë të mjaftueshme ligjore sipas nenit 62 të LPP-së.

Autoriteti Kontraktues, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (LPP), të ndryshuar dhe plotësuar, duke anuluar aktivitetin e prokurimit, duke u thirrur në një vendim të Zyrës së Kryetarit të Komunës (ZKA) për mungesë të buxhetit, pa argumentuar në mënyrë konkrete dhe të

mbështetur në ligj se cilat nga kushtet e përcaktuara në nenin 62 të LPP-së janë përmbushur për anulimin e këtij aktiviteti.

Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë arsyetim të mjaftueshëm se si mungesa e pretenduar e buxhetit përbën një nga shkaqet ligjore që lejojnë përfundimin e aktivitetit të prokurimit në fazën në të cilën ndodhet procedura. Referimi në një vendim të Zyrës së Kryetarit, në vetvete, nuk e përjashton detyrimin e Autoritetit Kontraktues për të vepruar në përputhje me LPP-në dhe për të dëshmuar se ekziston një bazë ligjore konkrete për anulim.

Neni 62, paragrafi 1, i LPP-së përcakton se Autoriteti Kontraktues mund ta përfundojë një aktivitet të prokurimit që nuk do të rezultojë me dhënie të kontratës vetëm për arsyet e përcaktuara shprehimisht në këtë dispozitë, përkatësisht:

-kur ka ndodhur ose do të ndodhë një shkelje ligjore e cila nuk mund të korrigjohet;

-kur të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që në masë substanciale tejkalojnë buxhetin e Autoritetit Kontraktues për aktivitetin përkatës;

-ose, para hapjes së tenderëve, kur ndërprerja bëhet e domosdoshme për shkak të ngjarjeve objektive, të demonstrueshme, jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues dhe të paparashikueshme në kohën e inicimit të aktivitetit.

Në rastin konkret, aktiviteti i prokurimit tashmë ka kaluar në disa faza pas hapjes së tenderëve, është zhvilluar procesi i vlerësimit dhe çështja është trajtuar dy herë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP). Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktues është i obliguar që anulimin ta mbështesë në një nga shkaqet ligjore të zbatueshme për fazën përkatëse të procedurës, duke paraqitur faktet dhe provat që e mbështesin atë.

Mungesa e mjeteve buxhetore, e paraqitur në mënyrë të përgjithshme, nuk duhet të barazohet automatikisht me kushtin e nenit 62, paragrafi 1.2, të LPP-së.

Rrjedhimisht, një vendim i mëvonshëm për mungesë buxheti nuk mund të mbështetet automatikisht në këtë dispozitë, pa u vlerësuar faza procedurale, rrethanat konkrete dhe baza e saktë ligjore e anulimit.

Për më tepër, neni 62, paragrafi 2, i LPP-së kërkon që njoftimi për anulim të përmbajë hollësi lidhur me arsyet faktike dhe bazën ligjore të anulimit. Kjo nënkupton se Autoriteti Kontraktues duhet të paraqesë arsyetim konkret, të individualizuar dhe të verifikueshëm, e jo vetëm t'i referohet një vendimi të brendshëm administrativ.

Nevoja reale dhe e vazhdueshme për shërbimet e servisimit të automjeteve

Objekti i këtij aktiviteti të prokurimit është servisimi i automjeteve që përdoren për nevojat e Komunës së Malishevës. Këto shërbime janë të domosdoshme për mirëmbajtjen dhe funksionalitetin e automjeteve zyrtare, si dhe për vazhdimin e rregullt të punëve dhe

shërbimeve të institucionit.

Përderisa nevoja e Autoritetit Kontraktues për këto shërbime vazhdon të ekzistojë, anulimi i aktivitetit vetëm me arsyetimin e përgjithshëm se aktualisht nuk ka mjete buxhetore, pa u dëshmuar plotësimi i kushteve ligjore për anulim, ngre dyshime serioze lidhur me ligjshmërinë, proporcionalitetin dhe arsyeshmërinë e këtij vendimi.

Nëse Komuna e Malishevës do të pretendonte se nuk ka më nevojë për servisimin e automjeteve, do të duhej të sqaronte se çfarë ka ndryshuar në nevojat e saj operative dhe si do të sigurohej funksionaliteti i automjeteve në vijim.

Megjithatë, për sa kohë që nevoja për këto shërbime mbetet e pranishme, Autoriteti Kontraktues duhet të japë një shpjegim të bazuar në fakte dhe ligj se përse është bërë i pamundur vazhdimi i kësaj procedure konkrete në këtë fazë.

A po bëhet anulimi në këtë fazë, sepse ne jemi i vetmi OE i përgjegjshëm në këtë procedurë dhe AK ka vendosur në qdo formë të na eleminojë neve në këtë procedurë të prokurimit !!!?.

Pretendimi 3: Cenimi i parimeve të transparencës, trajtimit të barabartë dhe vlerësimit objektiv

Ligji për Prokurimin Publik respektivisht nenet 1, 6 dhe 7, kërkojne që Autoriteti Kontraktues të zhvillojë procedurat e prokurimit në përputhje me parimet e transparencës, ekonomicitetit, efikasitetit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Në këtë rast, përsëritja e anulimit pas vendimit të OSHP-së, e shoqëruar me mungesën arësyeshmërisë ligjore, krijon pasiguri lidhur me mënyrën se si është realizuar rivlerësimi dhe nëse janë zbatuar në mënyrë të njëjtë kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Për më teper anulimi i dytë me rëdhë e vendimi i tretë, ku ne si Operator Ekonomik, në asnjë formë nuk trajtohemi të barabart, ngre dyshime serioze se AK ka vendosur që të mos na trajtojë ashtu siq kërkon neni 7 i LPP-së:

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

> Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.
>
> Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.

Bazuar në faktet dhe argumentet e paraqitura më lart, kërkojmë nga OSHP qe ta

detyroje Autoritetin Kontraktues – Komuna e Malishevës, që:

-Ta ktheje Lenden në RIVLERËSIM.

-Të zbatojë plotësisht Vendimet e OSHP-së me të cilin aktiviteti i prokurimit është kthyer në rivlerësim dhe ta vazhdojë procedurën në përputhje me udhëzimet e OSHP-së dhe dispozitat e LPP-së.

Pas rivlerësimit të ligjshëm, të marrë vendimin përkatës për dhënien e kontratës, në përputhje me rezultatet e rivlerësimit dhe dispozitat e prokurimit public duke na shpallur neve fitues në këtë procedurë si OE i përgjegjjshëm me çmimin më të ulët.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shkelja e supozuar ka ndikuar drejtpërdrejt në krijimin e dëmeve materiale për kompaninë tonë, duke cenuar parimin e trajtimit të barabartë dhe duke sjellë elemente të diskriminimit në këtë procedurë. Si pasojë, ne jemi të detyruar të përballojmë kosto shtesë, përfshirë shpenzimet administrative dhe financiare që lidhen me përgatitjen dhe zhvillimin e procedurës së ankesës. Këto kosto shtesë përfaqësojnë barrë të panevojshme për operatorin ekonomik dhe dëmtojnë pozitën tonë konkurruese në treg.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*